

Dita Botërore e të Rinjve

12 Gusht

DITA BOTERORE E TE RINJVE

Dita Ndërkombëtare e Rinisë është më 12 gusht të çdo viti. Ajo është caktuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1999 me miratimin e rezolutës 54/120. Ajo është menduar si një mundësi për qeveritë dhe të tjerët për të tërhequr vëmendjen për çështjet rinore në mbarë botën. Koncerte, seminare, ngjarje kulturore, që përfshijnë zyrtarë dhe takime kombëtare dhe lokale qeveritare dhe organizatat rinore zhvillohen në botë në nder të Ditës Ndërkombëtare të Rinisë

Te rinjtë janë burim i paçmueshëm për çdo komunitet. Perspektiva e tyre unike, njohuritë, eksperiencia, i sjellin diversitet dhe pasuri projektit komunitar. Në vendin tonë pjesa më e madhe e popullatës janë të rinj dhe si të tilla ato janë potenciali kryesor për zhvillimin e shoqërisë duke qenë dhe pjesa më aktive e popullatës tonë.

Cilat probleme shqetesojne me shume rinine tone ne ditet e sotme?

1. *Problemet kryesore për të rinjtë në vendin tonë vijnë nga abuzimi me substancat të cilat çojnë në dëmtime të rënda si shëndetësore ashtu dhe psikologjike.*

Kështu sipas ESPAD (Studimi europian për përdorimin e alkoolit dhe drogave të tjera midis të rinjve në Shqipëri) rezultojnë se:

- Më shumë se një e treta(39.7%) kanë konsumuar të paktën një herë në jetë duhan, rreth 5.1% kanë konsumuar më shumë se 40 cigare gjatë jetës së tyre. Më tepër djem se vajza raportojnë të kenë konsumuar cigare.
- Pothuajse tre të katërtat(72.4%) e të pyeturve kanë provuar një ose më shumë pije alkoolike gjatë jetës së tyre, rreth 7.8% e të pyeturve kanë përdorur pije alkoolike në më shumë se 40 raste gjatë jetës së tyre. Më shumë djem se vajza raportuan të kenë konsumuar alkool. Konsumimi i alkoolit nga të rinjtë lidhet pashmangshmërisht edhe me numrin e lartë të aksidenteve që ndodhin në vendin tonë.
- Lidhur me përdorimin e marjuaes(kanabis)4.4% e të pyeturve raportuan ta kenë përdorur atë të paktën një herë në jetë.
- Rreth 13.5% e të pyeturve raportuan të kishin provuar minimalisht një herë gjatë jetës një lloj droge të paligjshme(përfshirë mariuana, sedative pa recetë mjekesore dhe alkool të kombinuar me pilula)

2. *Sjeljet seksuale të të rinjve mund të çojnë në probleme të mëdha shëndetësore kur ato kryen në kushte të pambrojtura.*

Përdorimi i kondomëve si masë mbrojtëse mes të rinjve pamvarësisht se është bërë një punë e madhe informuese nga organet kompetente ende nuk është në ato nivele që pritet. Problemet me SIDA-n dhe të tjera SST (sëmundje seksualisht të transmetueshme) pamvarësisht se në nivele të ulëta e prekin këtë grup popullate.

3. Të tjera probleme lidhen me ushqyerjen dhe aktivitetin fizik tek të rinjtë

Mobilizimi i të rinjve si rruga më e mirë për të marrë më të mirën prej tyre.

Çelësi për të mobilizuar të rinjtë është të gjithë çështje që ata interesohen dhe për të cilat ja vlen që ata të shpenzojnë kohën dhe energjitë e tyre.

Të rinjtë kanë më pak mundësi të duan të jenë pjesë e diçkaje që i fajëson dhe shkakton përgjegjësinë vetëm mbi shpatullat e tyre.

Të rriturit duhet të mësojnë se si të jenë bashkëpunëtorë-mbështetës, duke i udhëzuar dhe duke punuar paralelisht me të rinjtë.

Pjesëmarrja e të rinjve është themelore. Çelësi për të mobilizuar të rinjtë që të kontribuojnë kohën e tyre, talentin, dhe energji për projektin tuaj qëndron në lehtësimin e suksesshëm të pjesëmarrjes së të rinjve.

Idetë e të rinjve janë supreme. Të rriturit duhet të mësojnë se si të zhvillojnë dhe të inkurajojnë idetë e të rinjve.

Kultura jonë, e shtyrë nga sistemi arsimor dhe media shpesh i trajton të rinjtë si marres pasiv të informacioni dhe jo si pjesëmarrës aktiv në jetën e komunitetit.

Pengesa më e madhe për pjesëmarrjen e të rinjve janë të rriturit, ata mund të ndajnë fuqinë me të rinjtë, të promovojnë zëra të rinj në shoqëri. Marrëdhënia të rritur-të rinj dhe projektet janë më të përshtatshme për sukses kur të rinjtë njihen si burime dhe u jepen role lidhësi si organizues, planifikues, avokate dhe edukatore